



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PRRENJAS

Nr. 630 Prot.

Prrenjas, më 26.032021

URDHËR

Nr. 76, datë 26 / 03 /2021

**“PËR VENDOSJEN E MATERIALEVE PROPAGANDISTIKE DHE VENDET E  
AFISHIMIT GJATË FUSHATËS ZGJEDHORE”**

Në mbështetje të nenit 8, nenit 9, nenit 64 të Ligjit nr.139/2015 “ Për Vetqeverisjen Vendore”; nenit 79 të Ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar; Ligjit Nr.8580, datë 17.2.2000 “Për Partitë Politike”, i ndryshuar; Ligjin nr. 8224 datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë dhe komunës” i ndryshuar; Udhëzimit Nr.1 datë 31.05.2017, i ndryshuar me Vendimin nr.153 datë 11.04.2019 të Komisionit Qëndror të Zgjedhore “Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore” ,

**URDHËROJ:**

- 1.Pranë zyrave dhe ambienteve të çdo Njësie Administrative të Bashkisë Prrenjas të kryhet afishimi i materiale edukative zgjedhore, në dispozicion të Komisionit Qëndror të Zgjedhore ose palëve të treta që nuk promovojnë fushatën e një subjekti të caktuar zgjedhor.
- 2.Në vendet e afishimit të përcaktuara sipas pikës 1, subjektet zgjedhore lejohen të afishojnë vetëm materiale të programeve të tyre zgjedhore.
- 3.Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore lejohet përdorimi dhe afishimi i materialeve propagandistike zgjedhore statike në një distancë jo më të madhe se 5 metra larg zyrës elektorale të subjektit zgjedhor.
- 4.Të gjitha subjektet zgjedhore duhet të japin informacion për adresat e sakta të zyrave elektorale dhe brënda 5 ditëve, pas marrjes e informacionit nga subjektet zgjedhore të bëhet verifikimi i vendodhjes së tyre dhe respektimi i dispozitave të Vendimit nr.153 datë 11.04.2019 të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr. 1, Datë 31.05.2017 “Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”

5. Policia Bashkiake merr masa të menjëhershme për heqjen e materialeve propagandistike të afishuara dhe të vendosura në kundërshtim me këtë urdhër dhe me kriteret e përcaktuara në udhëzimin përkatës të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve .

6. Ngarkohet Drejtorja e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit, Aseteve dhe Mbrojtjes Civile, Policia Bashkiake , për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhëri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I BASHKISË**  
**NURI BELBA**

